



BASHKIA TIRANË KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.73, datë 7.10.2016

PËR

“PAJISJEN ME ÇERTIFIKATË PËRDORIMI TË OBJEKTEVE TË NDËRTUARA NË SHKELJE TË KUSHTEVE TË NDËRTIMIT, TË CILAT NUK JANË OBJEKT I LIGJIT NR.9482, DATË 3.4.2001 “PËR LEGALIZIMIN, URBANIZIMIN DHE INTEGRIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE”(I NDRYSHUAR)

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”; nenit 5, nenit 27, nenit 29 nenit 42 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 për “Planifikimin e territorit” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 për “Miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” (i ndryshuar); nenin 12, Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 për “Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 58, date 30.12.2015 për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016–2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016” (i ndryshuar); me propozimin e Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Të pajisë me çertifikatë përdorimi objektet e ndërtuara në shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit, të cilët nuk mund të jenë objekt trajtimi në bazë të Ligjit 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizmin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” (i ndryshuar). Afati i lejes së ndërtimit për këto objekte duhet të ketë përfunduar.
2. Subjektet e interesuara, zhvillues/ndërtues ose përfitues (posedues të njësive të shërbimit apo banimit mbajtës të ligjshëm të kontratave të shkëmbimit/sipërmarrjes/porosisë dhe aktmarrëveshjeve të ngjashme), mund të paraqesin kërkesë pranë Bashkisë së Tiranës brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
3. Në bazë të kërkesës/ave të paraqitura struktura përgjegjëse të kryejë aktkontrollin që vërtetojnë se (i) objektet janë kryer në shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit dhe se (ii) në ditën e kontrollit nuk kanë sipërfaqe dhe volume shtesë në raport me ato të miratuara me lejen e ndërtimit.

4. Në bazë të aktkontrollit të kryer sipas pikës 3 të këtij vendimi dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti zhvillues/ndërtues/përfituesi i interesuar, struktura përgjegjëse të kryejë rishikimin e kushteve të lejes së ndërtimit.
5. Pajisja me çertifikatë përdorimi bëhet pas kryerjes së procedurave të përcaktuara në pikën 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi dhe dorëzimit nga zhvilluesit/ndërtuesit/përfituesit të dokumentacionit sipas projektit të rishikuar.
6. Objektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi të pajisen me çertifikatë përdorimi për sipërfaqe dhe volumin e përcaktuar në lejen e ndërtimit të rishikuar.
7. Në zbatim të pikës 5 të këtij vendimi Bashkia e Tiranës të kryejë kolaudimin e objekteve vetëm nëse (i) subjekti zhvillues/ndërtues është shpallur i falimentuar, është likuiduar apo është inaktiv dhe nëse (ii) poseduesit e njësive të shërbimit apo banimit mbajtës të ligjshëm të kontratave të shkëmbimit/sipërmarrjes/porosisë dhe aktmarrëveshjeve të ngjashme, nuk gjejnë dakordësi për kryerjen e procedurave të kolaudimit të objektit nga ana tyre. Në këtë rast të ndiqet procedura e përcaktuar në paragrafin 7 të nenin 12 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 për “Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, (i ndryshuar).
8. Në zbatim të pikës 7 të këtij vendimi, në rastet kur mungon dokumentacioni i mbikëqyrjes së punimeve, apo mbikëqyresi mungon për të njëjtat arsye të përcaktuara në pikën 7 të këtij vendimi, për zhvilluesin/ndërtuesin të ndiqet procedura e përcaktuar në paragrafin 8 të nenit 12 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 për “Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, (i ndryshuar).
9. Efektet financiare për përballimin e kostos së kolaudimit dhe mbikëqyrjes sipas pikës 7 dhe 8 të këtij vendimi të përballohet nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2017 dhe vitet në vijim.
10. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë të detajojë me urdhër procedurën dhe dokumentacionin që duhet të paraqesin subjektet e interesuarë në zbatim të këtij vendimi.
11. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit Financiar.
12. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI